



## Shtyhet thirrja për Mobilitete (Bursa) studentësh të UPT-së, në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus + në Anhalt University of Applied Sciences, Gjermani

Në kuadër të programit Erasmus + dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, është shtyrë thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, për në Anhalt University of Applied Sciences, Gjermani.

**Kohëzgjatja e bursave:** 4.5 muaj

**Periodha brenda së cilës do të vendoset bursa studimore:**

Semestri i dytë, 01.04.2021 – 30.09.2021

**Fusha e studimit:** Urbanistikë - 2 studentë

**Gjuha e huaj:** Anglisht, ose gjermanisht (niveli B2)

### **Dokumentat e nevojshme për aplikim:**

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit;
- Listë notash e studimeve deri në momentin e aplikimit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj\*;
- Dokumenti Learning Agreement\*\*

*\*Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze dhe në gjuhën gjermane, ku niveli minimal i kërkuar për të dyja gjuhët është B2. Nëse do të përzgjidhen lëndë që zhvillohen në të dyja gjuhët, studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar për të dyja këto gjuhë duke e vërtetuar me çertifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.*

*\*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Përcaktimi i lëndëve për t'u ndjekur do të bëhet me propozim nga aplikanti dhe aprovim nga drejtuesi i Departamentit që drejton programin e Studimit. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Mobility Plan". Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës. Në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakultetin e Arkitekturës e Urbanistikës, kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*Dokumenti "Learning Agreement" tek seksioni "Commitment" firmoset nga aplikanti, nga koordinatori akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Anhalt, Gjermani, lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryeni në semestrin përkatës në Fakultetin tuaj. Kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura do të ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në Fakultetin tuaj, në semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës.*

*Për të shkarkuar formatin e "Learning Agreement" klikoni si më poshtë:*

[https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/documents/applicants/learning-agreement\\_en](https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/documents/applicants/learning-agreement_en)

*Info për studentët:*

[www.hs-anhalt.de/en/international/studyexchange-and-intership-abroad/erasmus-incoming-students.html](http://www.hs-anhalt.de/en/international/studyexchange-and-intership-abroad/erasmus-incoming-students.html)



---

*Info për studimet:*

[www.hs-anhalt.de/ne/studieren/orientierung/studienangebot.html](http://www.hs-anhalt.de/ne/studieren/orientierung/studienangebot.html)

*Info për studimet në Master të Arkitekturës:*

<https://www.hs-anhalt.de/nc/en/study/orientation/study-guide/detail/architecture-dia-master-of-arts.html>

*Info për studimet në Master të Arkitekturës së pejsazhit:*

<https://www.hs-anhalt.de/nc/en/study/orientation/study-guide/detail/landscape-architecture-master-of-arts.html>

**Afati për aplikim për studentët: Deri më 03 Dhjetor 2020**

**Dokumentacioni dorëzohet pranë Sekretarisë në FAU**